



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE
PRIVREDNI SUD – COMMERCIAL COURT

Raporti i Rregullt i Punës

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Tetor - Dhjetor 2023

**RAPORTI I PUNËS SË GJYKATËS KOMERCIALE
(Periudha 1 tetor - 31 dhjetor 2023)**

Bazuar në nenin 16 paragrafi 2 pika 2.5 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, Kryetari i Gjykatës Komerciale të Republikës së Kosovës, paraqet raportin e punës për periudhën e tremujorit të IV-të 2023 (1 tetor - 31 dhjetor 2023).

Gjykata Komerciale, përmes këtij raporti ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të hollësishme të punës së gjykatës gjatë Tremujorit të IV-të të vitit 2023, duke synuar përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj publikut dhe palëve pjesëmarrëse.

Përmes këtij raporti prezantohet në mënyrë përmbledhëse puna e gjykatës për periudhën e tremujorit të IV-të të vitit 2023, duke prezantuar, sfidat gjatë kësaj periudhe raportuese, si në aspektin profesional ashtu edhe në atë administrativ, me qëllim të paraqitjes së volumit të punës së kryer e po ashtu edhe ngecjet dhe sfidat qoftë në aspektin procedural gjyqësor apo administrativ, ashtu edhe në atë logjistik të cilat mund të kenë penguar procesin e punës.

Gjykata Komerciale e Kosovës, gjatë kësaj periudhe raportuese procesin profesional të punës, e ka kryer me shtatëmbëdhjetë (17) gjyqtar, gjashtë (6) prej tyre janë të caktuar në gjykojnë në Dhomat e Shkallës së Dytë, ndërsa njëmbëdhjetë (11) gjyqtar janë të caktuar të gjykojnë në Dhomat e Shkallës së Parë.

Numri aktual i gjyqtarëve të caktuar në Gjykatën Komerciale, përkatësisht në Dhomat e Shkallës së Parë, konsiderojmë se nuk do të jetë i mjaftueshëm për zgjidhjen sa më efikase dhe efektive të lëndëve, duke marrë parasysh kompetencat që i ka kjo gjykatë dhe rritjen e trendit në ardhje të lëndëve të pranuar dhe atyre në kompetencë të cilat vetëm gjatë

kësaj periudhe raportuese janë evidentuar 337 lëndë të pranuar nga Gjykatat Themelore dhe ajo e Apelit *(të gjitha këtë lëndë janë të viteve para 2022, pra nuk janë të përfshira lëndët e pranuar që i përkasin vitit 2022 apo 2023)*, ndërsa mbi 1.500 lëndë janë lëndë të reja, andaj është e rëndësishë së veçantë që të shtohen kapacitetet në mënyrë që të lehtësohet menaxhimi me ngarkesën me lëndë.

Edhe në fillim të këtij tremujori të IV-të gjykata ka vazhduar funksionin e saj me kapacitete jo të plota në aspektin e plotësimit të të gjitha pozitave administrative të cilat parashihen me organogramin e Gjykatës Komerciale, disa pozita janë plotësuar dhe gjatë kësaj periudhe kanë filluar punën pesë (5) bashkëpunëtor profesional nga fillimi i muajit tetor 2023 dhe trembëdhjetë (13) zyrtar ligjor nga fillimi i muajit nëntor 2023, megjithatë presim që SKGjK sa më shpejtë të filloj me procedurën e rekrutimit për plotësimin e të gjitha pozitave të lira, dhe vetëm pas plotësimit të të gjitha pozitave presim që gjykata të jetë plotësisht funksionale, ashtu që edhe trajtimi i lëndëve do të bëhet në përputhje me afatet ligjore, dhe sipas kësaj do të krijohet edhe siguri juridike, njëkohësisht edhe rritja e besueshmërisë së publikut në sistemin e drejtësisë .

Sfidat dhe problemet me të cilat është ballafaquar dhe po ballafaqohet gjykata, edhe gjatë këtij tremujori, kanë të bëjnë me mungesën e hapësirave për kryerjen e punëve zyrtare, mungesën e stafit gjyqësor por edhe stafit tjetër mbështetës profesional, administrativ në gjykatë, gjë që vazhdon të pengojë funksionimin normal të gjykatës, e rrjedhimisht të cenon të drejtat për gjykim në kohë të arsyeshme, për shkak të numrit të madh të lëndëve të trashëguara nga gjykatat e Kosovës, por edhe numrin e madh të lëndëve në ardhje.

Plani i Veprimit për Reduktimin e Lëndëve – maj – dhjetor 2023

Kryetari i Gjykatës Komerciale ka adresuar çështjet, po ashtu ka ndërmarr veprime në kuadër të kompetencave që përcaktohen me ligjin për Gjykatën Komerciale, që të mos ketë ngecje në zgjidhjen e lëndëve dhe rritjen e performancës së gjykatës. Por edhe përkundër mungesës së kapaciteteve humane e buxhetore, gjykata gjatë kësaj periudhe ia kanë dal të zgjidh një numër të konsiderueshëm të çështjeve gjyqësore.

Pranimi i qindra çështjeve gjyqësore të pazgjidhura nga Gjykatat Themelore të Kosovës dhe ajo e Apelit, dhe lëndët e reja të pranuar, përkundër numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve dhe stafit administrativ dhe profesional, në raport me numrin e lëndëve, në anën tjetër përfundimi i mbi 2.050 lëndëve vetëm gjatë kësaj periudhe raportuese (*nga funksionalizimi numri total i lëndëve të zgjidhura është mbi 7.280 lëndë*), është treguesi më i mirë për përkushtimin dhe angazhimin e stafit të gjykatës për avancimin kuptimplotë në shkurtimin e kohës së procedimit të çështjeve gjyqësore të të gjitha lëmive, eliminimin substancial të lëndëve të vjetra, atyre të kthyer në rigjykim, e gjithë kjo me qëllim të ndërtimit të imazhit të një institucioni të respektuar, të drejtë dhe profesional në shoqëri.

Me qëllim të funksionalizimit të plotë, dhe rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në zgjidhjen e lëndëve, Gjykata Komerciale gjatë muajit prill ka hartuar Planin e Veprimit për Reduktimin e Lëndëve për periudhën maj – dhjetor 2023.

Objektivat e planit të veprimit maj – dhjetor 2023 të Gjykatës Komerciale, janë rritja e efikasitetit, eliminimi i vonesave, ngritja e kualitetit të shërbimeve gjyqësore në veçanti e vendimeve gjyqësore, rritja e besueshmërisë dhe llogaridhënies. Plani i veprimit, vë në fokus kryesisht lëndët të cilat duhet të trajtohen me prioritet siç përcaktohet edhe me Strategjinë për Qasje në Drejtësi, përkatësisht sipas këtij plani në fokus do të jenë lëndët përmbartimore; lëndët në rigjykim dhe lëndët e vjetra.

Përmes këtij plani të veprimit si dhe në kuadër të Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi, Efikasitetin dhe Prioritizimin e rasteve brenda sistemit gjyqësor, dhe me qëllim të ofrimit të drejtësisë për të gjithë, duke promovuar sundimin e ligjit dhe zhvillimin ekonomik, gjatë periudhës maj – dhjetor 2023, planifikon që të zgjidh rreth 5.000 lëndë.

Ndërsa, bazuar në këtë plan të veprimit, vetëm gjatë kësaj periudhe raportuese të tremujorit të IV-të 2023, norma e spastrimit të lëndëve në Gjykatën Komerciale ka arritur masën e mbi 108.33%.

Zyra e Kryetarit

Kryetari i Gjykatës, me qëllim të organizimit të punës së gjykatës dhe funksionalizimit të plotë të saj, si dhe funksionet gjyqësore të departamenteve të gjykatës, gjatë kësaj periudhe raportuese ka zhvilluar takime me gjyqtarët e gjykatës, janë mbajtur takime me udhëheqës të departamenteve të gjykatës dhe sipas nevojës janë mbajtur edhe takime të veçanta me gjyqtar, lidhur me rritjen e efikasitetit të punës së gjykatës.

Ndërsa në fund të muajit dhjetor është mbajtur edhe takimi vjetor me të gjithë gjyqtarët e gjykatës, me të cilin rast janë diskutuar raportet statistikore të gjykatës për vitin 2023, raportet individuale të gjyqtarëve, prioritetet e gjykatës për vitin 2024, si dhe është diskutuar dhe miratuar Plani Vjetor i Punës së Gjykatës Komerciale për vitin 2024.

Gjatë kësaj periudhe kryetari i gjykatës ka zhvilluar takime të shumta, me akter veprimtaria e të cilëve mund të ketë ndikim në aspektin rritjes së efikasitetit, por edhe ngritjes së besueshmërisë së opinionit publik në përgjithësi në sistemin gjyqësor. Janë zhvilluar takime të shumta me përfaqësues të projektit të USAID – Drejtësia Komerciale dhe Projekti për Drejtësi, përmes të cilit projekt gjykata është mbështetur edhe në përgatitjen e Strategjisë së Gjykatës Komerciale për vitin 2024 – 2025; Planin Vjetor të punës.

Zyra e Kryetarit të Gjykatës Komerciale, gjatë kësaj periudhe tetor – dhjetor 2023, ka kryer shtatëdhjetetë (78) kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve.

Raporti i monitorimit për zbatimin e normës së punës së gjyqtarëve

Kryetari i Gjykatës bazuar në Rregulloren e KGJK-së nr. 03/2023 për normën e punës së gjyqtarëve, neni 22 paragrafi 1 i kësaj rregullore, paraqet në mënyrë individuale raportet e gjyqtarëve të Dhomave të Shkallës së Dytë dhe gjyqtarëve të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale.

Ky raport i paraqitur në formë tabelare është një pasqyrë e monitorimit të implementimit të Normës së Punës së Gjyqtarëve për periudhën e tremujorit të IV-të të vitit 2023.

Nr	Dhomat e Shkallës së Dytë	Tremujori i IV-të Zbatimi i Normës së Punës
1	Saranda Bogaj Sheremeti	386
2	Krenar Berisha	293
3	Franciska Zhitija Ymeri	363
4	Dren Rogova	302
5	Faton Bajrami	421
6	Ramush Bardiqi	312

Nr	Dhomat e Shkallës së Parë	Tremujori i IV-të Zbatimi i Normës së Punës
1	Alajdin Tërshnjaku	368
2	Verona Dibra	362
3	Hasan Kryeziu	404.5
4	Fisnik Nuli	322
5	Arnis Dumani	297
6	Vlora Pacolli Rexhepi	278
7	Gent Bekeri	371
8	Arbër Rexha	360
9	Florent Zeqiri	360
10	Vera Gashi Bala	304
11	Arben Toska	320

Administrata

Administrata gjyqësore e Gjykatës Komerciale, me kapacitetet aktuale më të cilat vepron është menaxhuar mbi bazën e parimeve të profesionalizmit. Administrata, gjegjësisht zyra e Administratorit të gjykatës, gjatë kësaj periudhe ka kryer me sukses aktivitetet e

nevojshme rreth menaxhimit të stafit administrativ. Administrata është menaxhuar nga U.D. administratori i kësaj gjykate Ismet Musliu.

Informimi i publikut - transparenca

Publiku ka qenë i informuar rregullisht mbi punën dhe veprimtarinë e gjykatës, qoftë përmes deklarimeve për media, intervistave të ndryshme, apo përmes komunikimit zyrtar e po ashtu edhe përmes rrjeteve social. Në tremujorin e IV-të të këtij viti, gjykata ka publikuar 1.293 vendime të Dhomës së Shkallës së Dytë dhe Shkallës së Parë.

Përveç kësaj, Zyra për informim në vazhdimësi përmes portalit gjyqësor e po ashtu edhe rrjeteve social, ka publikuar orarin e seancave gjyqësore, njoftimet e ndryshme lidhur me punën e gjykatës apo aktivitetet e tjera, të cilat i kanë mundësuar publikut qasje më e lehtë në punën e gjykatës.

Vetëm gjatë kësaj periudhe raportuese në ueb portalin gjyqësor janë publikuar 416 seanca gjyqësore të cilat janë planifikuar të mbahen në muajt tetor, nëntor dhe dhjetor në Dhomat e Shkallës së Parë .

Zbatimi i programit TIK/SMIL

Gjykatën Komerciale, ende nuk ka filluar së implementuari Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (TIK/SMIL), i cili vlerësohet se ka treguar sukses dhe rritje të efikasitetit dhe transparencës së gjykatave të cilat tashmë janë duke e implementuar. Megjithatë gjatë kësaj periudhe raportuese, gjykata ka filluar futjen e të dhënave, përkatësisht regjistrimin e lëndëve të reja të pranuar përmes SMIL, andaj është e nevojshme që në afatin sa më të shkurtër kohorë dhe as plotësimin të pozitave të lira të punës, gjykata të largoj nga përdorimi regjistrat manual siç përcaktohet me Vendimin 265/2020 të KGJK-së të datë 7 dhjetor 2020, për Planin e Projektit të Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL), për largimin e regjistrave manual nga përdorimi në gjykata.

Njësia Ligjore

Njësia Ligjore, gjatë kësaj periudhe raportuese ka kryer detyrat e saj në mbështetje të punës profesionale të gjyqtarëve të Gjykatës Komerciale, duke kryer hulumtime dhe analiza juridike, duke ndihmuar në hartimin e raporteve, vendimeve dhe materialeve të tjera ligjore gjyqtarët dhe gjykatën. Gjatë kësaj periudhe raportuese Njësia Ligjore ka përfunduar gjithsej 686 vendime gjyqësore. Ndërsa është e nevojshme që të hapet procedura e rekrutimit për Kreun e Njesisë Ligjore.

Logjistika dhe financat

Sa i përket çështjeve logjistike, gjatë tremujorit të IV-të gjendja shfaqet e mirë në krahasim me periudhën paraprake.

Sa i përket çështjeve financiare në Gjykatën Komerciale kanë arritur gjithsejtë të procesohen për pagesë deri më 31.12.2023 , 36 fatura (të zotuar, të shpenzuara dhe të Certifikuara) në shumë prej 42,905.52 Euro.

Gjithashtu vështirësi tjetër ka qenë mungesa e stafit në Zyrën për Buxhet dhe Financa dhe është dashur që të autorizojmë më punë shtesë zyrtarët e Gjykatës Themelore të Prishtinës për të kryer obligimet buxhetore.

Andaj kërkohet që në afatin sa më të shkurtër të fillohet me procedurat e rekrutimit të zyrtarit të financave dhe logjistikës dhe vartësve të këtyre zyrave.

Statistikat


Bazuar në planin vjetor të punës së Gjykatës Komerciale, si dhe Strategjisë për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi, Efikasiteti dhe Prioritizimi të lëndëve brenda Sistemit Gjyqësor, si dhe bazuar edhe në opinionet e Komitetit Këshillëdhënës për Etik Gjyqësore, gjykata me prioritet ka shqyrtuar edhe zgjidhjen e lëndëve të cilat kërkohet që të trajtohen me prioritet, siç përcaktohet edhe me ligjet në fuqi.

Në këtë periudhë, Gjykata Komeriale ka shqyrtuar dhe kryer një numër të konsiderueshëm të çështjeve të ndryshme komerciale. Numri i rasteve ka qenë në rritje në krahasim me periudhën e mëparshme.

Gjatë kësaj periudhe raportuese Gjykata nga periudha paraprake ka trashëguar 9.397 lëndë, ka pranuar 1.897 lëndë në punë, ka zgjidhur 2.055 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 9.239 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 108.33%.


Dhomat e Shkallës së Parë

Norma e spastrimit të lëndëve 95.86%



Dhomat e Shkallës së Dytë

Norma e spastrimit të lëndëve 148.55%




Dhoma e Shkallës së Dytë

Në Dhomat e Shkallës së Dytë janë të angazhuar gjashtë (6) gjyqtar. Dhoma e Shkallës së Dytë përbëhet nga gjashtë (6) kolegje dhe secili nga kolegjet e shkallës së dytë kanë kryetarin e kolegjit dhe anëtarët gjyqtar.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykata Komeriale, nga 1 tetor 2023 - 31 dhjetor 2023, kanë pranuar gjithsej 449 lëndë, ka zgjidhur 667 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 780 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 148.55%.

Statistikat në këtë tremujor, të cilat paraqiten në vijim të këtij raporti në formë të grafikave pasqyrojnë, efikasitetin në kryerjen e lëndëve në Gjykatën Komeriale për periudhën raportuese.



Dhoma e Shkallës së Parë

Gjykata Komeriale, përkatësisht Dhomat e Shkallës së Parë të kësaj periudhe raportuese, kanë pranuar 1.148 lëndë, prej tyre 315 nga Gjykatat Themelore të Kosovës. Lëndë të përfunduara raportohen të jenë 1.388, ndërsa të pa përfunduara janë të evidentuara 8.459. Norma e spastrimit të lëndëve për Dhomat e Shkallës së Parë është 95.86%.

Departamenti për Çështje Ekonomike - Me çështjet gjyqësore të Departamentit për Çështje Ekonomike, kanë vendosur tre (3) gjyqtar të caktuar edhe me Planin Vjetor të Punës së Gjykatës Komerciale. Në fillim të muajit mars janë angazhua me lëndë përmbareme edhe dy (2) gjyqtar, ndërsa në fillim të muajit qershor edhe dy (2) gjyqtar të tjerë. Të dhënat statistikore për këtë periudhë raportuese në këtë departament, evidentojnë lëndë të pranuar 1.046, të përfunduara 1.191, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 5.262 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë raportuese është 113.86% .

Në Divizionin Lidhur me Kontestet me Investitorët e Huaj, evidenton tre (3) lëndë të pranuar dhe një (1) e zgjidhur, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura pesëmbëdhjetë (15) lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë raportuese është 33.33% .


Departamenti Fiskal – Në këtë departament është caktuar të gjykojë një (1) gjyqtar. Bazuar në të dhënat statistikore, për periudhën raportuese, ky departament ka trashëguar nga tremujori i III-të 1.286 lëndë, ka pranuar 225 lëndë, ka përfunduar 60, ndërsa mbesin të papërfunduara 1.451 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 26.67%.

Departamenti për Çështje Administrative - Në këtë departament janë caktuar të gjykojnë dy (2) gjyqtar. Departamenti për Çështje Administrative, për këtë periudhë raportuese ka trashëguar 1.612 lëndë, ka pranuar 165 lëndë, ka zgjidhur 118 lëndë, ndërsa kanë mbetur në punë të papërfunduara 1.659. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 71.52%.

Departamenti i Përgjithshëm - Në këtë departament është caktuar të gjykojë një (1) gjyqtar. Lëndë të trashëguara janë 71, të pranuar 19 lëndë, të zgjidhura 18 lëndë, ndërsa kanë mbetur në punë të papërfunduara 72 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 94.74%.

Në grafikun në vijim paraqiten të dhënat për Dhomat e Shkallës së Parë, lëndët e pranuar

në raporte me numrin e lëndëve të përfunduara, përkatësisht efikasiteti sipas llojit të lëndëve paraqitur në përqindje.



Përfundimi

Si përfundim vlerësoj se periudha e tremujorit të IV-të e Gjykatës Komerciale, të ketë rezultuar e suksesshme në aspektin e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi të punës, si në aspektin teknik ashtu edhe në atë profesional. Bazuar edhe në planin vjetor të punës gjyqtarët janë caktuar apo ri-caktuar në departamentet përkatëse, të gjitha lëndët janë regjistruar në regjistrat manual të gjykatës.

Efikasiteti i punës së Gjykatës Komerciale varet nga numri i rasteve që ajo ka në dorë, numri i gjyqtarëve dhe stafit tjetër që punon në gjykatë. Një gjykatë që ka një numër të madh të rasteve dhe një numër të vogël të gjyqtarëve, mund të ketë probleme në përmbushjen e detyrave dhe në arritjen e vendimeve në kohë. Kjo mund të çojë në ritme të ngadaltë të procesit gjyqësor, gjë që mund të ndikojë në besueshmërinë e publikut ndaj

sistemit gjyqësor, përkatësisht Gjykatës Komerciale. Andaj është e nevojshme që të rrisim kapacitetet tona dhe në afatin sa më të shkurtër, të plotësojmë të gjitha pozitat e lira të përcaktuara edhe me organogramin e gjykatës,

Presim që në vitin 2024, pas aprovimit të Draft Strategjisë për Gjykatën Komerciale për vitin 2024 – 2025 dhe Planit të Veprimit për Reduktimin e Lëndëve, dhe me angazhimin e plotë të të gjithë gjyqtarëve në departamentet përkatëse, të shënohet rezultat pozitiv si në akseptin e zgjidhjes së numrit të lëndëve, ashtu edhe në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të Gjykatës Komerciale.

Megjithatë me krenari dëshmoj se Gjykata Komerciale është vazhdimisht duke punuar me përkushtim për të ofruar drejtësi të shpejtë për të gjitha palët, edhe përkundër sfidave me të cilat është ballafaquar gjykata, megjithatë ky është një tregues i një angazhimi të të gjithëve që të arrihet shkalla e spastrimit të lëndëve në masën e 108% për këtë periudhë të tremujorit të IV-të të vitit 2023.

Mahir TUTULI

Kryetar i Gjykatës Komerciale

